



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS - VLADA - GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT MINISTARSTVO OBRAZOVANJA, NAUKE I TEHNOLOGJIE MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARCHIVE - ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	5
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	2
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	1860
Data Datum Date	16.08.2024
Pristine / Pr	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Datë: 16-08-2024
Nr. 5/1860

Komisioni për licencimin dhe rilicencim të BPrAL në Ministrin e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 11 paragrafi 3 dhe 4, dhe neni 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037- në bazë të neneve 5, 6, 7 dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë dhe Udhëzimit Administrativ nr. 17/2023 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ (MASHT) 25/2012 për licencimin e bartësve privat të Arsimit të Lartë në Kosovë, kërkesës nr. 1860 të datës 26.06.2024 të parashtruar nga BPrAL- Kolegji "Biznesi" nxjerr :

V E N D I M

1. Bartësit Privat të Arsimit të Lartë / Kolegjit "Biznesi" dega në Prizren rilencenohet në nivel Institucional sipas vendimit të AKA-s nr. 876/24, datë 10.05.2024 për periudhën (3) vjeçare (1 tetor 2024 deri me 30 shtator 2027) si dhe për programin e studimit "Banka dhe Financa në Biznes – BA, po ashtu për periudhën (3) vjeçare (1 tetor 2024 deri me 30 shtator 2027) sipas vendimit të AKA-s, ref. 1708/ 24 të datës 20.08.2024.

1. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në mbështetje të dispozitave ligjore të cekura më lartë, komisioni për licencim dhe rilicencim të BPrAL/ Kolegjeve Private i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, pas shqyrtimit të kërkesës nr. 1860 të datës 26.06.2024 të parashtruar nga kolegji "Biznesi", vlerëson se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet dhe kriteret ligjore për licencim. Licenca e këtij institucioni privat të arsimit të lartë zgjat tri vite akademike, bazuar në vendimet e Agjencionit të Kosovës për Akreditim, pra për periudhën kohore nga data 1 tetor 2024 deri me 30 shtator 2027 si në dispozitiv të pika 1.

Komisioni për Licencim dhe rilicencim në MASHTI duke marrë parasysh faktet e ofruara nga ky institucion si dhe dokumentacionin e kompletuar për aplikim, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim, mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi në Komisionin për ankesa të nëpunësve publik dhe ankesave të tjera në MASHTI.

Vendimi u dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës;
2. Komisionit për licencim;
3. Sekretarit të përgjithshëm;
4. DALSHT;
5. Inspektoratit të Arsimit;
6. DNJBIA
7. Arkivit.

Kryetar i Komisionit

Burim Gashi

